



Këtë javë në komisionet parlamentare

■ U shqyrtuan 5 projektligje dhe dy projektvendime të rëndësishme:

• Projektligjet:

- “Për buxhetin e vitit 2021”;
- “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;
- “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;
- “Për Censin e popullsisë dhe të banesave”;
- “Për ndryshimet klimatike”

• Projektvendimet:

- “Për miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave të punonjësve me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”;
- “Për miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave të punonjësve me kohë jo të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”;

Këtë javë në komisionet parlamentare

■ Projekt-buxheti 2021

- **Komisioni për Ekonominë dhe Financat** zhvilloi seancë dëgjimore për të marrë opinionin e Bankës së Shqipërisë lidhur me projekt-buxhetin e vitit 2021. Komisioni për Ekonominë dhe Financat, shqyrtoi raportet e të gjitha komisioneve kuvendore dhe miratoi në parim projekt-buxhetin e vitit 2021.
- **Komisioni për Sigurinë Kombëtare** zhvilloi seanca dëgjimore me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, në lidhje me projekt-buxhetin e vitit 2021.
- **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut** miratoi në parim projekt-buxhetin e vitit 2021.
- **Komisioni për Politikën e Jashtme** miratoi nen për nen dhe në tërësi projekt-buxhetin 2021 për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrinë e Shtetit për Diasporën.
- **Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik** shqyrtoi në parim projekt-buxhetin 2021. Zhvilloi seanca dëgjimore me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; rektorë të universiteteve publike të Tiranës dhe rretheve, Drejtorinë Përgjithshme të Arkivave; Akademinë e Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike; Këshillin Drejtues të RTSH, ATSH.
- **Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë** seancë dëgjimore me grupet e interesit në lidhje me projekt-buxhetin e vitit 2021.

Seanca plenare

■ **Kuvendi miratoi në parim projekt-buxhetin 2021 dhe 1 projektvendim**

Kuvendi u mbledh në seancë plenare dhe në drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, miratoi në parim projekt-buxhetin e vitit 2021, si edhe projektvendimin “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve me kohë jo të plotë pune në KQZ”.

Pas prezantimit parimor të projekt-buxhetit sipas fushave të veprimtarisë për ministrinë përkatëse, pas diskutimeve të secilit prej ministrave, u vijua me diskutimet e deputetëve dhe diskutimet

Aktivite parlamentare

■ **Mblidhet Konferenca e Kryetarëve**

- Konferenca e Kryetarëve, e mbledhur nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, shqyrtoi dhe miratoi sot kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 9 - 27 nëntor 2020. Konferenca vendosi zhvillimin e seancave plenare në datat 16,19 dhe 26 nëntor. Në përfundim të mbledhjes, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, tërhoqi vëmendjen për zbatimin më rigoroz të protokolleve të mbrojtjes nga pandemia Covid-19 në veprimtarinë parlamentare.

Aktivite parlamentare

■ Mbledhet Këshilli i Integritit, ministri i Brendshëm raporton mbi Kapitullin 24

- Këshilli Kombëtar i Integritit Evropian zhvilloi mbledhjen e radhës. Në këtë mbledhje raportoi ministri i Brendshëm, z. Sandër Lleshaj. Raportimi i ministrit Lleshaj ishte mbi progresin e realizuar dhe sfidat në kuadër të Kapitullit 24, me fokusin në 15 pikat e Vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian të dt. 25 mars 2020 për hapjen e negociatave dhe në raportin e Komisionit Evropian (tetor 2020). Mbledhja, në mungesë të kryetares, u drejtua nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Integritit, z. Taulant Balla. Në fillim të takimit, z. Balla u shpreh se pas publikimit të raportit të progresit nga Komisioni Evropian, KKIE, në prag të marrjes së vendimit për Konferencën e Parë Ndërqeveritare, synon të përcjellë mesazhin që Shqipëria është fuqimisht e ankoruar në projektin historik të integritit. Z. Balla shtoi se kjo vendosmëri duhej shoqëruar me vetëdije për sfidat dhe me gatishmëri për të përmbushur detyrat sektoriale të vendosura nga Komisioni Evropian.

■ Nisi edicioni i pestë i Shkollës së Integritit Evropian

- Nisi online Shkolla e Integritit Evropian 2020, nismë e Këshillit Kombëtar të Integritit Evropian dhe Kuvendit të Shqipërisë në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe fondacionet "Shoqëria e Hapur" dhe "Friedrich Ebert". Ceremoninë e përshëndetën z. Taulant Balla, në cilësinë e zëvendëskryetarit të Këshillit Kombëtar të Integritit Evropian; z. Luigi Soreca, ambasador i delegacionit të BE-së në Shqipëri dhe znj. Stine Clapper, drejtore Ekzekutive e "Friedrich Ebert".

Aktivite të Kryetarit të Kuvendit

- **Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, letër solidariteti Presidentit të Këshillit Kombëtar të Austrisë, z. Eölgang Sobotka: Solidaritet e simpati me popullin austriak dhe familjet që humbën të dashurit nga akti terrorist**

3 Nëntor 2020 - Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, i ka dërguar sot në letër solidariteti Presidentit të Këshillit Kombëtar të Austrisë, z. Eölgang Sobotka. “Me trishtim e dhimbje të thellë përjetova humbjet e jetëve njerëzore si pasojë e aktit terrorist në Vienë. Terroristët sulmuan mbrëmë kryeqytetin e vendit Tuaj, Vienën, një ndër qytetet më të bukura të botës dhe një ndër pavionet e qytetërimit. Në emër të Kuvendit të Shqipërisë si edhe në emrin tim personal Ju transmetoj Juve, Këshillit Kombëtar e popullit austriak ndjenjat e solidaritetit e simpatisë si edhe ngushëllimet tona të singerta për familjet që humbën të dashurit e tyre. Cilatdo qofshin motivet e këtij veprimi terrorist, ato tregojnë se civilizimi dhe vlerat njerëzore e perëndimore janë ende të kërcënuara nga barbaria dhe se përpjekjet e njerëzimit për tolerancë, bashkëjetesë, paqe e siguri po vazhdojnë të sfidohen nga impulset e errëta. Këto akte po dëmtojnë përpjekjet e popujve, komuniteteve e qytetarëve për të mbrojtur jetët njerëzore nga pandemia, i bëjnë jetët e tyre më vulnerable dhe na ndihmojnë të dallojmë më qartë ata që ndërtojnë e sakrifikojnë në emër të dashurisë dhe ata që sulmojnë, vrasin e masakrojnë në emër të urrejtjes.”, shkruan Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi.

- **Kryetari i Kuvendit, z. Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, deklaratë mbi dorëheqjen e Presidentit Thaçi: UÇK dhe udhëheqësit e saj, në anën e duhur të historisë**

5 Nëntor 2020 - Pas dorëheqjes së Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, ka reaguar nëpërmjet deklaratës së mëposhtme:
“Dorëheqja e Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe deklarimi i tij për t’u përballuar me drejtësinë është një akt emancipimi, përgjegjësie dhe vendosmërie për t’u përballur dhe për të mbrojtur të vërtetën dhe të drejtën. Vepra e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është çlirimi i Kosovës dhe pavarësia e saj, e arritur me mbështetjen e popullit të Kosovës dhe në partneritet me aleatët e mëdhenj dhe strategjikë të Shqipërisë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-n. Populli kosovar dhe udhëheqësit e luftës çlirimtare kanë qenë në anën e duhur dhe të drejtë të historisë. Drejtësinë e kësaj lufte e ka vërtetuar koha. Në gjykimin për të vërtetën, gjithkush mund të ketë interpretimet e veta, por jo faktet e veta. Faktet dhe e vërteta janë një dhe vetëm një: Kosova, Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe udhëheqësit e saj ishin viktimat përballë agresorit dhe jo e kundërta. Jam i bindur se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe drejtuesit e tjerë të kësaj lufte do të dinjë ta pohojnë këtë të vërtetë përballë drejtësisë dhe do të venë në vend nderin, dinjitetin dhe kontributin historik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në shërbim të popullit të vet, të lirisë, të drejtësisë dhe të paqes. Ata kanë mbështetjen e të gjithë shqiptarëve si edhe të gjithë njerëzve të planetit që aspirojnë për lirinë, drejtësinë dhe të vërtetën”.